



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 23.11.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03L-040, nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit 01. nr.06- 75711-19/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me 23.10.2015, me të cilin është aprovuar kërkesa e Shoqatës “Hendicap-Kosova” dega në Gjakovë për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të 30 personave anëtar të kësaj shoqate për pjesëmarrje në ahengun që do të mbahet në qytetin e Ferizajt, me dt: 23.11.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës “Hendicap -Kosova”- dega në Gjakovë nr. 09-347-66680 e dt. 29.09.2015 për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të 30 personave për pjesëmarrje në ahengun që do të mbahet në qytetin e Ferizajt me dt. 01.01.2016.
2. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerë prej 250€ nga subvencionet e Drejtorisë për Shërbime Publike, në emër të shërbimeve të N.T.P “Çlirimi” me seli në Gjakovë sipas faturës nr. 014505 e dt. 30.10.2015, në emër të transportit të 30 personave në relacionin Gjakovë-Ferizajt dhe anasjelltas.
3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 250€, nga mjetet e subvencioneve Drejtorisë për Shërbime Publike dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e N.T.P “Çlirimi” me seli në Gjakovë nr. 1505001001066698 RFB.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë për Shërbime Publike
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - N.T.P “Çlirimi” Duzhnje, Gjakovë
 - Znj. Sanije Batusha, menaxhere e “Hendicap -Kosova” dega në Gjakovë
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari - Lila